

SKEDE INFORMIMI

THIRRJE E HAPUR PËR APLIKIME NËN IPA III, PROGRAMIN E BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR SHQIPËRI–KOSOVË 2021-2027

Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Shqipëri–Kosovë 2021-2027, i financuar nga Bashkimi European në kuadër të Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA III), është një kornizë e përbashkët zhvillimi që synon forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe nxitjen e integritit european përmes projekteve të përbashkëta lokale dhe rajonale. Programi fokusohet në nxitjen e zhvillimit social, ekonomik dhe territorial në zonat kufitare të dy vendeve, duke u bazuar në analiza të përbashkëta të sfidave dhe potencialeve të rajonit.

Prioritetet kryesore të programit janë mbrojtja e mjedisit, përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike dhe menaxhimi i rreziqeve, si dhe zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm natyror dhe kulturor. Zbatimi i programit bëhet përmes thirrjeve publike për projekte me partneritet ndërkufitar, ku institucionet publike dhe aktorë të tjerë lokalë bashkëpunojnë për ide dhe iniciativa që sjellin përfitime të ndërsjella për komunitetet e zonës së programit.

1. Qëllimi i thirrjes:

Thirrja e publikuar synon të forcojë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, të nxisë integrimin në Bashkimin European dhe të kontribuojë në zhvillimin social, ekonomik dhe territorial të zonës ndërkufitare përmes mbrojtjes së mjedisit, përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike, parandalimit dhe menaxhimit të rreziqeve si dhe zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm natyror e kulturor.

Prioritetet e thirrjes janë:

- **Prioriteti 1 / LOT 1:** Mbrojtja e mjedisit, promovimi i përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rreziqeve
- **Prioriteti 2 / LOT 2:** Inkurajimi i turizmit dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore

2. Objektiva specifike dhe rezultatet e pritshme të thirrjes:

1. Vlerësimi, mbrojtja dhe ruajtja e burimeve mjedisore në territorin ndërkufitar.

Rezultatet e pritshme:

- a) Kapaciteti i rajonit ndërkufitar për të mbrojtur mjedisin e tij dhe për të promovuar biodiversitetin është rritur.
- b) Rajoni ndërkufitar mund t'i përgjigjet në mënyrë efektive fatkeqësive natyrore dhe atyre të shkaktuara nga njeriu.

2. Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm natyror dhe kulturor kontribuon më shumë në zhvillimin ekonomik ndërkufitar.

Rezultatet e pritshme:

- a) Produktet, shërbimet dhe infrastruktura turistike ndërkufitare të jetë e re, më miqësore me mjedisin, me cilësi më të lartë dhe të integruar, të zhvilluar dhe të përmirësuar.
- b) Zonat e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të promovohen dhe zhvillohen më mirë.

3. Fushat dhe tipet e aktiviteteve:

Projektet duhet të kontribuojnë në një nga dy prioritetet tematike:

a) Mbrojtja e mjedisit, përshtatja dhe zbutja e ndryshimeve klimatike, menaxhimi i rreziqeve, aktivitete për menaxhimin e përbashkët të pyjeve dhe lumenjve, mbrojtjen e biodiversitetit, parandalimin e sëmundjeve transkufitare të kafshëve, menaxhimin e mbetjeve, përgatitjen për emergjencë, reduktimin e ndotjes, etj.

b) Nxitja e turizmit dhe promovimi i trashëgimisë natyrore e kulturore, zhvillimi i paketave të përbashkëta turistike miqësore me mjedisin, digjitalizimi i shërbimeve, promovimi i produkteve lokale, evente ndërkufitare kulturore dhe sportive, ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Aktivitetet duhet të kenë efekt të qartë ndërkufitar dhe të përfshijnë zhvillim dhe zbatim të përbashkët nga partnerët.

4. Kush mund të aplikojë:

Aplikuesi kryesor:

Aplikuesi kryesor duhet të jetë person juridik, jofitimprurës dhe të jetë një nga kategoritë: **bashki** dhe autoritete vendore/rajonale, shoqata bashkish, institucione publike që administrojnë shërbime publike (uji, emergjencat civile, parqe natyrore, trashëgimi kulturore), ministri dhe agjenci për mjedisin, OJQ, qendra arsimore dhe kërkimore, operatorë turistikë e bujqësorë. Aplikanti kryesor duhet të jetë **i regjistruar në Shqipëri ose Kosovë** dhe të ketë **të paktën një** bashkë-aplikues nga vendi tjetër. Çdo aplikim duhet të përfshijë **të paktën një institucion publik** (kombëtar, qarku, vendor) nga secili shtet dhe numri maksimal i bashkë-aplikantëve që mund të përfshihen në projekt është **3**.

Bashkë-aplikuesi(it):

Aplikuesi kryesor duhet të veprojë me **të paktën një bashkë-aplikues**. Nëse aplikuesi kryesor është në Shqipëri, të paktën një bashkë-aplikues duhet të jetë në Kosovë dhe anasjelltas.

Nëse aplikuesi kryesor ose bashkë-aplikuesi nuk janë as të vendosur në zonën e pranueshme dhe as nuk kanë një zyrë në atë zonë, duhet të sigurohen që në partneritet të ketë të paktën një subjekt të vendosur në zonë të pranueshme të të dy vendeve pjesëmarrëse.

Numri i aplikimeve dhe granteve për aplikues:

Aplikuesi kryesor nuk mund të paraqesë më shumë se **1 aplikim për lot**.

Aplikuesit kryesor nuk mund t'i jepet më shumë se **1 grant**.

Aplikuesi kryesor mund të jetë bashkë-aplikues ose një entitet i asociuar në **1 aplikim tjetër në të njëjtën kohë**.

Një bashkë-aplikues/entitet i asociuar mund të jetë bashkë-aplikues ose entitet i asociuar në deri në **dy aplikime për secilin lot**.

5. Zonat përfituese:

● Në Shqipëri:

- Bashkitë e **Qarkut Kukës** (Bashkitë Kukës, Has dhe Tropojë) dhe
- Bashkitë e **Qarkut Lezhë** (Bashkitë Lezhë, Mirditë dhe Kurbin).

- Në Kosovë:
 - Bashkitë e Rajonit Ekonomik Perëndimor (Bashkitë Pejë, Deçan, Gjakovë, Istog, Klinë, Junik) dhe
 - Rajoni Ekonomik Jugor (Bashkitë Prizren, Dragash, Rahovec, Suharekë, Malishevë dhe Mamushë).

6. Cili është buxheti i thirrjes dhe për projekt:

Buxheti i përgjithshëm indikativ i vënë në dispozicion për këtë thirrje është **5.280.000 euro**.

Shpërndarja sipas prioritetit/lotit tematik:

Prioriteti Tematik / LOT	Buxheti
LOT 1 - Mbrojtja e mjedisit, promovimi i përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rreziqeve	EUR 3.240.000
LOT 2 - Inkurajimi i turizmit dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore	EUR 2.040.000
Total	EUR 5.280.000

Shuma e grantit në dispozicion për secilin prioritet:

Prioriteti Tematik	Minimumi i grantit të financuar nga BE	Maksimumi i grantit të financuar nga BE
1. Mbrojtja e mjedisit, promovimi i përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rreziqeve	EUR 700.000	EUR 1.080.000
2. Inkurajimi i turizmit dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore	EUR 300.000	EUR 510.000

Financimi i kostove të kësaj thirrjeje për propozime do të jetë midis përqindjeve minimale dhe maksimale të mëposhtme të kostove totale të pranueshme të veprimit:

- Përqindja minimale: **70% e kostove totale** të pranueshme të veprimit.
- Përqindja maksimale: **85% e kostove totale** të pranueshme të veprimit.

7. Si bëhet aplikimi:

Aplikimi bëhet online përmes platformës PADOR duke përdorur seksionin PROSPECT, pas regjistrimit paraprak të subjektit në PADOR dhe në Portalin “Funding and Tenders” të Komisioni Evropian për marrjen e numrit PIC (Participant Identification Code).

Aplikimi është i ndarë në **dy etapa**:

- Fillimisht dorëzohet koncepti i projektit (Concept Note).
- Vetëm aplikantët e përzgjedhur do të ftohen të dorëzojnë aplikimin e plotë (Full application).

Për dërgimin e aplikimeve me konceptin e projektit, aplikimet duhet të dorëzohen në përputhje me udhëzimet e konceptit në formularin e aplikimit për grant të bashkëngjitur këtyre udhëzimeve (Shtojca A). Aplikuesit kryesorë duhet t'i përmbahen në mënyrë strikte formatit të konceptit dhe të plotësojnë paragrafët dhe faqet sipas radhës. Koncepti së bashku me deklaratën nga aplikuesi kryesor (Shtojca A.1 Seksioni 2) duhet të dorëzohen në Portalin PADOR nëpërmjet PROSPECT <https://webgate.ec.europa.eu/prospect> .

8. Kur është afati i fundit:

Afati i fundit për dorëzimin e koncepteve është **24 tetor 2025, ora 16:00** (data dhe ora e Brukselit).

9. Linku i thirrjes ku ndodhen udhëzuesit dhe ankeset e thirrjes:

<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/prospect-details/184245PROSPECTSEN>